

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

Nr. 01/482/2019

Datë: 27/11/2019

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 10 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e njëzet të përbërjes së parë, të mbajtur më 27 nëntor 2019, merr këtë:

## V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja Nr. 02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë.
2. Me miratimin e kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja Nr. 06/2017 - Për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë dhe Rregullorja Nr. 08/2017 - për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Aleksandër Lumezi  
  
Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë  
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë / Akademia Pravde / Academy of Justice*

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenit 24 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.11.2019,

Miraton:

**RREGULLORE NR. 02/2019**

**PËR TRAJNUESIT DHE MENTORËT E AKADEMISË SË DREJTËSISË**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo rregullore përcakton kriteret, procedurën e përzgjedhjes, mënyrën e angazhimit, vlerësimit, të drejtat dhe detyrat e trajnuesve dhe mentorëve të Akademisë së Drejtësisë.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Kjo rregullore zbatohet nga Akademia e Drejtësisë, trajnuesit, mentorët dhe organet e saj.

**Neni 3**  
**Përkufizimet**

1. Për qëllim të zbatimit të kësaj rregullore, shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:
  - 1.1 “Akademia” nënkupton Akademinë e Drejtësisë;
  - 1.2 “KGJK” nënkupton Këshillin Gjyqësor të Kosovës
  - 1.3 “KPK” nënkupton Këshillin Prokurorial të Kosovës
  - 1.4 “Trajnues” nënkupton gjyqtarët, prokurorët e shtetit dhe profesionistë të tjerë relevant, të angazhuar për të mbajtur trajnime në Akademi;
  - 1.5 “Mentor” nënkupton gjyqtarët dhe prokurorët e angazhuar për të mentoruar pjesëmarrësit në trajnim;

- 1.6 “Trajnues i përkohshëm” nënkupton gjyqtarë, prokurorë, avokat apo profesionist tjerë që angazhohet nga Akademia për zbatimin e një apo më shumë aktiviteti trajnues;
- 1.7 “Trajnues i përhershëm” nënkupton gjyqtarë, prokurorë apo profesionist tjetër që angazhohet në Akademi me orar të plotë pune;
- 1.8 “Profesionist tjerë” nënkupton ekspertë të fushave të veçanta të cilat janë pjesë e programit të trajnimeve të Akademisë;

#### **Neni 4 Trajnuesit**

1. Trajnuesit në Akademi janë gjyqtarë, prokurorë, profesorë universitarë dhe profesionistë të tjerë. Trajnuesit janë të përhershëm ose të përkohshëm.
2. Trajnuesit kryejnë aktivitete për ngritjen e aftësive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive dhe profesionistëve tjerë siç është përcaktuar me ligj, si dhe zbatimin e aktiviteteve tjera të Akademisë të përcaktuara me programin e trajnimeve dhe aktet normative të Akademisë.

#### **Neni 5 Trajnuesit e përhershëm**

1. Në Akademi janë të angazhuar dy lloje të trajnuesve të përhershëm, si në vijim:
  - 1.1 Gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët zgjedhën sipas procedurave të përcaktuara nga KGJK dhe KPK.
  - 1.2 Profesionist tjerë të cilët themelojnë marrëdhënie pune në Akademi sipas rregullave të shërbimit civil.
2. Trajnuesit e përhershëm të Akademisë zgjedhën duke u bazuar në kompetencën profesionale dhe ndërdisiplinore për realizimin e programit trajnues për aftësimin në fushat:
  - 2.1 Penale materiale dhe procedurale;
  - 2.2 Civile materiale dhe procedurale;
  - 2.3 Familjare dhe të punës;
  - 2.4 Administrative dhe kushtetuese;
  - 2.5 Ekonomike dhe financiare;
  - 2.6 Të drejtat e njeriut dhe legjislacioni ndërkombëtarë;
  - 2.7 Ndërdisiplinore dhe personale.

**Neni 6**  
**Kriteret për zgjedhjen e trajnuesve të përhershëm nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit**

1. Trajnuesit e përhershëm nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit duhet të plotësojnë kriteret si në vijim:
  - 1.1 Të kenë përvojë pune si gjyqtarë apo prokurorë me mandat të përhershëm në lëmin ku aplikon si trajnues;
  - 1.2 Të kenë njohuri nga didaktika (metodologjia trajnuese);
  - 1.3 Të jenë kreativ në hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e programit trajnues;
  - 1.4 Të kenë aftësi të larta komunikimi;
  - 1.5 Njohja e një gjuhe të huaj konsiderohet përparësi;
  - 1.6 Të kenë shkathtësi kompjuterike.
2. Trajnuesit e përhershëm nga paragrafi 1 i këtij neni mund të angazhohen pas miratimit nga Këshilli Drejtues i Akademisë.

**Neni 7**  
**Kriteret për zgjedhjen e trajnuesve të përhershëm të cilët nuk janë gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit**

1. Trajnuesit e përhershëm të cilët nuk janë gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit duhet të plotësojnë kriteret si në vijim:
  - 2.1 Të kenë përfunduar fakultetin juridik;
  - 2.2 Të kenë dhënë provimin e jurisprudencës;
  - 2.3 Të kenë së paku 8 vite përvojë pune prej të cilave së pak 5 vite përvojë profesionale nga lëmia e drejtësisë;
  - 2.4 Të kenë njohuri nga didaktika (metodologjia trajnuese);
  - 2.5 Të ketë aftësi të larta komunikimi;
  - 2.6 Njohja e një gjuhe të huaj dhe gradës shkencore konsiderohet përparësi;
  - 2.7 Të kenë kualitet të lartë profesional dhe moral;
  - 2.8 Të kenë shkathtësi kompjuterike.
3. Procedura për përzgjedhjen e trajnuesve nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil.

**Neni 8**  
**Trajnuesit e përkohshëm**

1. Trajnuesit e përkohshëm janë gjyqtarë, prokurorë, avokat, profesor universitar, apo ekspert të cilët angazhohen sipas nevojës për zbatimin e programit të trajnimeve.
2. Për tu zgjedhur trajnues i përkohshëm kandidatët duhet të plotësojnë kriteret si në vijim:

- 2.1 Të kenë përvojë pune profesionale së paku 5 vite për fushën apo temën në të cilën do të angazhohen;
  - 2.2 Të kenë përvojë si trajnues ose të kenë kryer trajnime për trajnues të organizuara nga Akademia apo institucione tjera të ngjashme;
  - 2.3 Të kenë vlerësime pozitive nga pjesëmarrësit e trajnimeve ku kanë qenë të angazhuar si trajnues;
  - 2.4 Të kenë kualitete të larta profesionale dhe morale;
  - 2.5 Të ofrojnë plan trajnues të detajuar për modulin, kursin, përkatësisht për temën që aplikojnë.
3. Trajnuesit e përkohshëm angazhohen në bazë të kontratës për shërbime të veçanta, sipas nevojës për zbatimin e programit trajnues.

### **Neni 9**

#### **Procedura për zgjedhjen e trajnuesve të përkohshëm**

1. Trajnuesit e Akademisë përzgjedhën në bazë të një procesi të hapur dhe konkurrues.
2. Në procesin e shpalljes publike për zgjedhjen e trajnuesve të Akademisë merren parasysh kriteret e përcaktuara me këtë rregullore.
3. Përrjashtim nga paragrafi 2 i këtij neni bëjnë trajnuesit që vijnë nga radhët e institucioneve jo gjyqësore dhe natyra e trajnimit kërkon ekspertizën nga këto institucione.
4. Përrjashtimisht, Akademia mund të angazhojë trajnues nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve edhe jashtë listës së përzgjedhur me konkurs të hapur konkurrues vetëm në rastet kur lista e trajnuesve nuk i plotëson nevojat për zbatimin e programit trajnues ose mund të jenë të propozuar dhe certifikuar si trajnues nga projektet e ndryshme që janë mbështetës të AD dhe implementues të punës në Akademi, por me kusht që të plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë rregullore.
5. Për trajnuesit e propozuar nga partnerët ndërkombëtarë të AD si formular aplikimi mund të konsiderohet marrëveshja e AD-së dhe partnerit ndërkombëtarë.
6. Njoftimi për aplikim për trajnues të përkohshëm bëhet në faqen zyrtare të Akademisë.
7. Aplikimi bëhet përrmes plotësimit të formularit, i cili dorëzohet në Akademi në kopje fizike apo elektronike. Formularit të aplikimit i bashkëngjiten edhe dokumentet si në vijim:
  - 5.1 Biografia (CV-ia);
  - 5.2 Emërtimi i modulit, kursit, apo temës për të cilën aplikon;
  - 5.3 Përrshkrimi i metodologjisë që do të përrdorë në trajnim;
  - 5.4 Përrshkrimi i shkurtër i problemeve praktike rreth modulit, kursit apo temës për të cilën aplikon;
  - 5.5 Plani trajnues i detajuar për modulin, kursin apo temën.
8. Drejtori Ekzekutiv i Akademisë merr vendim për themelimin e Komisionit për vlerësimin e dokumentacionit për përrzgjedhjen e trajnuesve të përrkohshëm.

9. Komisioni nga paragrafi 6 i këtij neni përgatitë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret për trajnues dhe ia propozon Drejtorit Ekzekutiv.
10. Drejtori Ekzekutiv pas konsultimeve me Këshillin Programor, listën e trajnuesve ia propozon për miratim Këshillit Drejtues të Akademisë.
11. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar si trajnues kanë të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh në Këshillin Drejtues.

### **Neni 10** **Të drejtat dhe detyrat e trajnuesve**

1. Trajnuesit e përhershëm nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit kanë të drejtë në pagën njëjtë të cilën do të kishin për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, respektivisht të funksionit të prokurorit të shtetit, e cila paguhet nga buxheti i KGJK-së, respektivisht KPK-së.
2. Trajnuesit e përhershëm nga radhët e shërbyesve civil kanë të drejtë në pagë në pajtim me Legjislacionin në fuqi;
3. Trajnuesit e përkohshëm kanë të drejtë në kompensim sipas vendimit të Këshillit Drejtues të Akademisë.
4. Trajnuesit e përhershëm gëzojnë të drejtën për pjesëmarrje në trajnime, konferenca, simpoziume, për avancimin e metodologjisë trajnuese dhe të ngritjes së kapaciteteve profesionale;
5. Trajnuesit zbatojnë programet trajnuese të Akademisë dhe ofrojnë trajnim cilësor;
6. Trajnuesit përgatitin materiale trajnuese dhe materiale ndihmëse.
7. Pas miratimit nga Këshilli Drejtues trajnuesit janë të detyruar të marrin pjesën në programet për Trajnim të Trajnuesve të Akademisë.
8. AD mund të ftojë në trajnim të trajnuesve edhe kandidatë të interesuar me qëllim të përgatitjes së tyre për trajnues në të ardhmen.

### **Neni 11** **Detyrat specifike të trajnuesve**

1. Trajnuesit e Akademisë së Drejtësisë kanë detyra si në vijim:
  - 1.1 Realizimin e trajnimit fillestar, gjegjësisht trajnimit të vazhdueshëm nga lëmia (dega) juridike relevante në pajtim me programin e Akademisë,

- 1.2 Përgatisin materialin trajnues me shkrim, të cilin e dorëzojnë jo më vonë se 15 ditë para mbajtjes së trajnimit;
- 1.3 Marrin pjesë në përgatitjen dhe realizimin e agjendës së trajnimeve përkatëse ose formave tjera të aftësimit dhe arsimimit profesional;
- 1.4 Marrin pjesë në përgatitjen e planit dhe programit vjetor të trajnimit të Akademisë dhe në realizimin e vlerësimit të nevojave për trajnim dhe arsimim profesional;
- 1.6 Analizojnë problemet dhe paqartësitë që identifikohen gjatë trajnimeve dhe nxjerrin rekomandime të cilat i dërgohen Akademisë jo më vonë se 15 ditë pas trajnimit;
- 1.8 Janë të pranishëm në mënyrë të vazhdueshme dhe pandërprerë gjatë gjithë trajnimit ku janë të angazhuar;
- 1.9 I përmbahen angazhimit për trajnimin përkatës ndërsa nëse heqin dorë ose në pamundësi të angazhimit e njoftojnë Akademinë 30 ditë para mbajtjes së trajnimit;

## **Neni 12**

### **Trajnuesit e trajnuesve**

1. Akademia angazhon trajnues të cilët përgatisin dhe ofrojnë trajnime për trajnuesit e angazhuar nga Akademia.
2. Trajnuesit e Trajnuesve janë ekspertë të fushave të caktuara dhe me njohuri të thella dhe të dëshmuara të aspekteve metodike dhe didaktike.
3. Procedura e zgjedhjes, angazhimit dhe kriteret e trajnuesve për trajnues përshtatshmërisht janë të njëjta me trajnuesit tjerë me përjashtim të ekspertizës ndërkombëtare.

## **Neni 13**

### **Mentorët**

1. Mentorët kryejnë aktivitetet për ngritjen e aftësive profesionale dhe praktike të gjyqtarit dhe prokurorit të sapoemëruar, në kuadër të trajnimit fillestar.
2. Mentorët me kërkesën e Akademisë marrin pjesë në hartimin e programit trajnues fillestar, për ngritjen e kapaciteteve praktike profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar.
3. Këshilli Drejtues i Akademisë miraton kandidatët për mentorët të propozuar nga KGJK dhe KPK.

## **Neni 14**

### **Kriteret për zgjedhjen e mentorëve**

1. Mentorët duhet të plotësojnë këto kriteret.
  - 1.1 të jenë gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit me mandat të përhershëm në departamentin e përgjithshëm. Në rast të numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve apo prokurorëve të shtetit në departamentin e përgjithshëm, mentorët mund të caktohen edhe gjyqtarët

apo prokurorët e shtetit të departamentit të krimeve të rënda. Nëse gjyqtarët e sapo emrëuar caktohen në departamentin e çështjeve administrative ose ekonomike të Gjykatës Themelore mentorë mund të caktohen edhe gjyqtarët që punojnë në këto departamente;

- 1.2 të jenë kreativ në hartimin dhe përdorimin e metodologjisë në zbatimin e programit të mentorimit përmes ofrimit të një plani të detajuar të programit praktik;
- 1.3 të kenë treguar performancë të mirë si gjyqtarë apo prokurorë;
- 1.4 të kenë treguar performancë të mirë si mentorë nëse kanë qenë të angazhuar më parë;
- 1.5 preferohet të kenë aftësi në përdorimin e metodologjisë trajnuese.

### **Neni 15**

#### **Të drejtat dhe detyrat e mentorëve**

1. Mentori jep shpjegime, udhëzime si dhe shembuj nga praktika duke i zbatuar ato praktikisht.
2. Mentori bënë vlerësimin për gjyqtarin, prokurorin e sapoemëruar ku përfshihet, performanca e tyre e përgjithshme si dhe aspekti i punës praktike profesionale;
3. Të respektojnë afatet e raportimit dhe komunikimit me Akademinë;
4. Mentorët kanë të drejtë në kompensim të përcaktuar nga Këshilli Drejtues i Akademisë.
5. Pas miratimit nga Këshilli Drejtues mentorët janë të detyruar të marrin pjesën në programet për trajnim të trajnuesve të Akademisë.

### **Neni 16**

#### **Vlerësimi i trajnuesve dhe mentorëve**

1. Vlerësimi i punës së trajnuesve dhe mentorëve bazohet në treguesit si në vijim:
  - 1.1 kontributi i dhënë në hartimin e planit dhe programit vjetor të trajnimit;
  - 1.2 përgatitja dhe mbajtja e trajnimit ku përfshihen koordinimi me trajnuesit tjerë, identifikimi dhe zbatimi i objektivave, metodologjia e trajnimit, përgatitja e materialit trajnues si dhe niveli profesional gjatë trajnimit;
  - 1.3 pjesëmarrja dhe rezultatet në procedurat e vlerësimit të nevojave për trajnim;
  - 1.4 puna e trajnuesve në cilësinë e moderatorit, ose ligjëruesit në trajnimet konkrete;
  - 1.5 vlerësimi i tyre pas çdo sesi apo modulit trajnues si dhe
  - 1.6 kontributi i dhënë me nxjerrjen e konkludimeve ose rekomandimeve pas sesioneve apo moduleve trajnuese.
2. Vlerësimi i trajnuesve dhe mentorëve bëhet nga pjesëmarrësit dhe Akademia sipas kritereve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

### **Neni 17**

#### **Ndërprerja dhe përfundimi i statusit të trajnuesit ose mentorit**



1. Trajnuesit ose mentorët të cilët për punën e tyre nuk marrin vlerësim pozitiv, me vendim të Këshillit Drejtues të Akademisë hiqen nga lista e trajnuesve ose mentorëve. KGJK dhe KPK njoftohen për heqjen nga lista të trajnuesve dhe mentorëve vetëm për gjyqtarët dhe prokurorët e propozuar nga këto dy këshilla
2. Ndërprerja e marrëdhënies së punës së trajnuesve të përhershëm që janë shërbyes civil, bëhet sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.



**Neni 18**  
**Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

1. Deri në zgjedhjen e trajnuesve sipas kësaj rregullore, për realizimin e aktiviteteve trajnuese, Akademia do të angazhoj trajnues nga lista ekzistuese për trajnues.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje pushon së vlejtori "Rregullorja Nr. 06/2017 - Për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë dhe Rregullorja Nr. 08/2017 - për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë.

**Neni 19**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Akademisë.

Prishtinë, 27.11.2019

  
Aleksandër Lumezi  
  
Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë